



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-101

Prishtinë, më 25 mars 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 25 MARS 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Glauk Konjufca, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 18 mars 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 18 mars 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 18 mars 2013.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi gjatë kësaj jave t'i mbajë dy mbledhje plenare, dhe atë:

Mbledhja plenare më 28 mars 2013, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Raportimi i kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e tij të shtatë me kryeministrin e Serbisë në Bruksel,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veprimtari kërkimore-shkencore, inovacione dhe teknologji,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet,

10. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,

11. Formimi i Komisionit hetimor parlamentar, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së, mbështetur edhe nga deputetë të tjerë,

12. Zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radha e komuniteteve joshumicë.

Mbledhja plenare më 29 mars 2013, me këtë:

Rend dite

1. Debat parlamentar për gjendjen ekonomike në Kosovë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës,

2. Shqyrtimi i raportit të performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2011,

3. Zgjedhja e një (1) anëtari të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Shqyrtimi i propozim-Planit Strategjik të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për periudhën 2013-2018

Propozim-Plani Strategjik i Veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2013-2018 u shty për mbledhjen e radhës.

2. Propozimi i kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Legjislacion që ta shqyrtojë kërkesën e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për riemërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

3. Kërkesa e deputetit Ramiz Kelmendi, i mbështetur nga deputetët nënshkrues, për debat parlamentar lidhur me ndryshimin e politikave fiskale në funksion të nxitjes, rritjes së prodhimitarisë vendore dhe zhvillimit ekonomik në tërësi

Kërkesa e deputetit Ramiz Kelmendi u shty për mbledhjen e radhës së Kryesisë.

4. Kërkesa e Grupit Parlamentar të LDK-së për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar

Për kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, nënkryetarë të Kuvendit; Adem Grabovci, kryetar i G/P të PDK-së, Ismet Beqiri, kryetar i G/P të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga grupet parlamentare që deri në seancën e radhës t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit Hetimor Parlamentar, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së.

2. Përbërja e komisionit duhet të jetë: GP i PDK-së 2 anëtarë, GP i LDK-së 2 anëtarë, GP VV 1 anëtar, GP i AAK-së 1 anëtar, GP i KKR-së 1 anëtar, GP i SLS-së 1 anëtar, GP "6+" 1 anëtar dhe dy anëtarë nga radha e deputetëve pa grup parlamentar.

5. Përfundimi i Komisionit për Legjislacion lidhur me kërkesën e Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje" për debat parlamentar

Kryesia u njoftua me përfundimin e Komisionit për Legjislacion lidhur me kërkesën e Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje" për debat parlamentar. Kjo kërkesë duhet të radhitet në rend dite në mbledhjen tjetër plenare të radhës.

6. Njoftimi i deputetit Enis Kervan për lirimin e pozitës të nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia e radhiti këtë pikë në rend dite të mbledhjes plenare më 28 mars 2013.

7. Kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme për mbulimin e shpenzimeve me rastin e vizitës së Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit Kombëtar të Hungarisë

Kryesia e miratoi në parim kërkesën e Komisionit për Punë të Jashtme për mbulimin e shpenzimeve për pritjen e delegacionit të Kuvendit Kombëtar të Hungarisë, që do ta vizitojë Kuvendin e Kosovës, prej datës 10 deri më 12 prill 2013.

Njëkohësisht, Kryesia konstatoi se propozuesi duhet ta saktësojë kërkesën me shënime plotësuese për përbërjen e delegacionit, koston e shpenzimeve dhe t'ia parashtrojë Kryesisë së Kuvendit për mbledhjen e radhës.

Pika shtesë:

1. Kërkesa e kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, për të raportuar në Kuvend lidhur me takimin e tij të shtatë me kryeministrin e Serbisë në Bruksel

Kërkesa e kryeministrit të Kosovës për ta informuar Kuvendin e Kosovës për takimin e tij të shtatë me kryeministrin e Serbisë u radhit në rend dite të mbledhjes plenare më 28 mars 2013. Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale